



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOPIET
KRYETARI
Niko PELESHI

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AVOKATIT TË POPULLIT
PËR VITIN 2024

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur rolin dhe rëndësinë e organeve të barazisë në një shoqëri demokratike, ku të drejtat dhe liritë themelore të çdo individi duhet të respektohen;

Në mbështetje të mandatit të Avokatit të Popullit si institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike;

Duke marrë në konsideratë angazhimin e Avokatit të Popullit për të kryer funksionin e tij në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar, veçanërisht Parimet e Parisit dhe të Komisionit të Venecias;

Vlerëson veprimtarinë e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2024 në këto drejtime:

Fushëveprimin e gjerë të veprimtarisë së institucionit dhe rekomandimet që kanë pasur efekt të menjëhershëm rregullues, ndonëse kërkohet ndjekje më efektive e zbatimit të tyre;

Forcimin e aksesit dhe besimit të publikut ndaj institucionit, ku vihet re rritje e ndjeshme e numrit të kërkesave të adresuara.

Zhvillimin e një veprimtarie të gjerë mbikëqyrëse në sistemin penitenciar dhe përmirësimin e kushteve të trajtimit të personave të privuar nga liria, duke ushtruar ndikim konkret për respektimin e dinjitetit dhe të drejtave të njeriut.

Mbikëqyrjen e strukturave të rendit dhe sigurisë publike, ku janë adresuar shkelje të të drejtave të qytetarëve dhe janë mbrojtur gjithashtu interesat legjitime të punonjësve të policisë dhe gardës, në një kuadër të balancuar institucional.

Analizën e funksionimit të sistemit të drejtësisë penale përmes evidentimit të problematikave sistematike, si: vonesat, mungesa e transparencës dhe shkeljet e procesit të rregullt ligjor, si dhe adresimit të rekomandimeve konkrete për institucionet përgjegjëse.

Trajtimin e çështjeve të pronësisë dhe qeverisjes vendore, me theks te mangësitë institucionale dhe procedurale, që ndikojnë në sigurinë juridike të qytetarëve dhe cilësinë e shërbimeve publike.

Mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve përmes ndërhyrjeve të drejtpërdrejta, avokimit edukues dhe rritjes së ndërgjegjësimit, ku vihet re edhe pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e fëmijëve në paraqitjen e kërkesave.

Adresimin e problematikave në sistemin shëndetësor dhe të mbrojtjes sociale, me fokus në përmirësimin e qasjes në shërbime dhe garantimin e dinjitetit të qytetarëve.

Promovimin e të drejtave të të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara përmes ndërhyrjeve konkrete, bashkëpunimit ndërinstitutional dhe kontributit në hartimin e politikave kombëtare për moshimin aktiv dhe gjithëpërfshirës.

Angazhimin në luftën kundër dhunës me bazë gjinore dhe femicidit përmes ngritjes së Observatorit për Femicidet, publikimit të raporteve analitike dhe zhvillimit të fushatave ndërgjegjësuere, që kanë forcuar rolin e institucionit në parandalimin dhe adresimin e kësaj forme të dhunës.

Kuvendi rekomandon që Avokati i Popullit për vitin 2025 të angazhohet në këto drejtime:

1. Të vijojë punën për hartimin e draftit të ri për ndryshimet në ligjin organik të Avokatit të Popullit, Planin Strategjik dhe Planin e Veprimit për periudhën 2025–2029, duke reflektuar prioritetet dhe objektivat për rritjen e ndikimit në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
2. Të ushtrojë më tej të drejtën për propozime ligjore dhe të rrisë ndikimin në konsultimet formale publike dhe institucionale, me synim harmonizimin e legjislacionit me standardet më të mira ndërkombëtare dhe kërkesat e procesit të integritetit evropian.
3. Të forcojë transparencën institucionale përmes publikimit të rregullt dhe të aksesueshëm të statistikave, rekomandimeve dhe dokumenteve relevante, si dhe përmes përmirësimit të mëtejshëm të faqes zyrtare në funksion të informimit dhe ndërveprimit me qytetarët.
4. Të zgjerojë aktivitetet ndërlidhëse me komunitetin, duke bashkëpunuar edhe me Kuvendin për të ndikuar direkt në informimin dhe fuqizimin e shtresave më të pambrojtura të shoqërisë.
5. Të forcojë kapacitetet institucionale dhe burimet buxhetore të institucionit për të përballuar rritjen e kërkesave për ndërhyrje dhe shërbime, në zbatim të detyrimit kushtetues për garantimin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.
6. Të përditësojë dhe strukturojë faqen zyrtare të Avokatit të Popullit si një instrument funksional transparence dhe llogaridhënieje, me qëllim rritjen e aksesueshmërisë për publikun dhe ndikimin e informacionit të publikuar në politikëbërje dhe ndërgjegjësim qytetar.
7. Të vijojë roli proaktiv në monitorimin dhe analizimin e zbatimit të rekomandimeve, në funksion të përmirësimit të përputhshmërisë me standardet e të drejtave të njeriut dhe realizimit të detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian.

Miratuar në datën 30.10.2025